



# **STATUTI I**

## **Koalicionit për KOMRA**

Teksti i pastruar  
26 qershor 2011

# Dispozita e përgjithshme

## **Neni 1. Definicioni i Koalicionit**

Koalicioni për KOMRA (në tekstin e mëtejshëm: Koalicioni) është rrjeti i organizatave dhe individëve misioni i të cilëve është angazhimi për vendosjen e Komisionit rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës si dhe shkeljeve tjera të rënda e të drejtave të njeriut në hapësirat e ish - RSFJ-së (në tekstin e mëtejshëm: KOMRA) në periudhën kohore prej vitit 1991 deri në vitin 2001 të cilin me marrëveshje do e themelojnë shtetet në hapësirat e ish - RSFJ-së.

## **Neni 2. Emri i Koalicionit**

(1) Emri i Koalicionit është *Koalicioni për themelimin e Komisionit rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës si dhe shkeljeve tjera të rënda e të drejtave të njeriut në hapësirat e ish - RSFJ-së.*

(2) Shkurtesa e emrit është *Koalicioni për KOMRA.*

## **Neni 3. Përmbajtja e Statutit**

Me Statutin e Koalicionit (në vazhdim: Statuti) rregullohen qëllimet themelore të veprimit, parimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve/anëtareve, organizimi i brendshëm, zgjedhjet, kompetencat e organeve, si dhe çështje tjera të rëndësishme për punën e Koalicionit.

## **Neni 4. Mandati i Koalicionit**

Mandati i Koalicionit është:

- Organizimi i konsultimeve në kuadër të shoqërisë civile në shtetet e krijuara në hapësirat e ish - RSFJ-së mbi modelin KOMRA.
- Hartimi i modelit KOMRA, të cilin, Koalicioni do ju dorëzojë në shqyrtim parlamenteve të shteteve të krijuara në hapësirat e ish - RSFJ-së.
- Promovimi në media dhe sigurimi i mbështetjes publike dhe politike për themelimin e KOMRA-s.
- Organizimi i pjesëmarrjes së qytetarëve /reve duke favorizuar themelimin dhe veprimin e KOMRA-s, si dhe realizimi i rekomandimeve të tij.
- Prezantime publike dhe favorizimi i KOMRA-s para organeve më të larta shtetërore të krijuara në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme dhe organizatave ndërkombëtare.
- Presioni ndaj institucioneve shtetërore të krijuara në hapësirat e RSFJ së dikurshme , për të

hapur debat parlamentar mbi nevojën për qasje rajonale ndaj të kaluarës, iniciativës dhe modelit të KOMRA-s.

- Mbështetja e KOMRA-s në zbatimin e mandatit të tij.
- Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të KOMRA-s.

#### **Neni 5. Territori i veprimit**

- (1)Koalicioni , aktivitetet e tija do i implementojë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kroaci, Kosovë, Maqedoni , Slloveni dhe Serbi.
- (2)Avokimi dhe promovimi i KOMRA-s mund të implementohet edhe në shtete tjera.

#### **Neni 6. Shenja dhe logoja e Koalicionit**

- (1)Koalicioni ka shenjen dhe logon e vet.
- (2)Logoja e Koalicionit detyrimisht shfrytëzohet në të gjitha aktivitetet e Koalicionit.
- (3)Shenja e Koalicionit gjendet në Shtojcën nr. 1 të këtij Statuti.
- (4)Logoja e Koalicionit gjendet në Shtojcën nr. 2 të këtij Statuti.

#### **Neni 7. Përfaqësimi i Koalicionit**

- (1)Koalicionin e përfaqësojnë anëtarët/et e Këshillit koordinues të Koalicionit për KOMRA, anëtarët/et e Grupit për koordinimin e konsultimeve, koordinatori/et dhe organizatat, organizatorët e konsultimeve dhe aktiviteteve përcjellëse në nivelin lokal, shtetërorë/nacional dhe rajonal.
- (2)Për marrjen e punëve juridike në emër të Koalicionit është i nevojshëm autorizimi/vendimi në formë të shkruar nga ana e Këshillit koordinues.

#### **Neni 8. Metodologjia e punës**

Koalicioni qëllimet e tija i realizon duke organizuar forume dhe këshillime, konferenca për gazetarë, takimet e anëtarëve/reve të Koalicionit si dhe fushatave në media, editimin e publikimeve, duke iu drejtuar opinionit, institucioneve relevante dhe në mënyra tjera, sipas vendimit të Këshillit koordinues , përkatësisht Kuvendit.

# Anëtarësimi në Koalicionin për KOMRA

## Neni 9.

### Dispozita themelore për anëtarësim

- (1) Anëtar/re e Koalicionit mund të jetë çdo organizatë dhe person i cili i pranon qëllimet dhe Statutin.
- (2) Anëtar/e e Koalicionit bëhet me dorëzimin e deklaratës së nënshkruar mbi anëtarësimin në Koalicion.
- (3) Anëtar/e e Koalicionit nuk mund të jetë organizata e cila në programin dhe aktivitetet e saja favorizon urrejtjen racore, fetare ose nacionale, mizogjininë, homofobinë ose forma tjera të urrejtjes të cilat paraqesin nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë.
- (4) Anëtar/e e Koalicionit nuk mund të jetë personi i cili publikisht favorizon qëndrimet dhe zbaton aktivitete të cilat janë të përshkruara në paragrafin 3 të këtij neni.
- (5) Anëtar/e e Koalicionit nuk mund të jetë personi i gjykuar në prezencë për krime lufte.
- (6) Anëtarit/es së Koalicionit i cili/la është akuzuar për krime lufte Anëtarësimi i tij/saj do jetë i ngjirë . Vendimin për shkrirje të anëtarësisë e merr Këshilli koordinues .
- (7) Vendimin lidhur me atë se a ekzistojnë pengesa anëtarësie nga paragrafi 3 i këtij neni e merr Këshilli koordinues me kërkesë të, minimum, një anëtari/re të Koalicionit.
- (8) Të dhënat mbi anëtarët/et e Koalicionit i udhëheqë Sekretariati/Sekretaria e Koalicionit (në vazhdim: Sekretariati/Sekretaria) i cili harton regjistër unik të anëtarëve/eve të Koalicionit (në vazhdim : Regjistri i anëtarëve/reve).

## Neni 10.

### Të drejtat e anëtarëve/eve

Të drejtat e anëtarëve/eve janë:

- Të zgjedhë dhe të jetë i/e zgjedhur në organet e Koalicionit në përputhje me këtë Statut dhe me aktet tjera të përgjithshme dhe të veçanta të Koalicionit
- Të jetë i/e informuar për aktivitetet e Koalicionit
- Të merr pjesë në punën e Koalicionit
- Të fitoj mbështetje në rast të rrezikimit të të drejtave të tija themelore për shkak të anëtarësimit në Koalicion dhe angazhimeve në aktivitetet e Koalicionit
- Të realizoj të drejta tjera të parapara me këtë Statut dhe me aktet tjera të përgjithshme dhe të veçanta Koalicionit.

**Neni 11.**  
**Detyrat e anëtarëve/reve**

Detyrat e anëtarëve/reve të Koalicionit janë:

- Të respektojë Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme dhe të veçanta të Koalicionit
- Të angazhohet për realizimin e qëllimeve dhe misionit të Koalicionit
- Të mbroj interesat, të ruaj dhe të avancoj imazhin e Koalicionit
- Të merr pjesë në punët, të merr pjesë në mbledhjet e organeve dhe trupat e Koalicionit anëtar/re i të cilave është.

**Neni 12.**  
**Pushimi i anëtarësisë**

(1) Anëtarësimi në Koalicion mund të pushojë me dalje ose me përjashtim.

(2) Nëse Anëtari/ja dëshiron të dal nga Koalicioni, lidhur me atë duhet me shkrim ta informoj Zyrën/drejtorinë e tij/saj nacionale ose Këshillin koordinues .

(3) Propozimin për përjashtim të anëtarit/es me arsyetim drejtuar Këshillit koordinues, mund ta ushtroj çdo anëtar/re i Koalicionit.

(4) Këshilli koordinues për propozimin e konsulton Komisionin Statutar i cili jep mendimin e vet.

(5) Këshilli koordinues merr vendim lidhur me këtë propozim në mbledhjen e parë të radhës.

(6) Vendimi i Këshillit koordinues mbi përjashtimin e anëtarit/es i suspendon të drejtat dhe detyrimet e tij/saj si anëtar/e e Koalicionit.

(7) Kundër vendimit për përjashtim lejohet ankesa drejtuar Kuvendit, e cila ushtrohet përmes Zyrës/drejtorisë në shtetin nga i cili vjen anëtari/ja e përjashtuar e Koalicionit, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit për përjashtim.

(8) Kuvendi merr vendimin përfundimtarë mbi përjashtimin e anëtarit/es me shumicën prej 2/3 e votave të pjesëmarrësve prezentë në mbledhjen e parë të radhës .

(9) Sekretariati/Sekretaria zbaton vendimin mbi përjashtimin e anëtarit/es me shlyerjen e anëtarit/es nga Regjistri i anëtarëve/reve.

## Struktura Organizative e Koalicionit

### Neni 13.

#### Trupat udhëheqëse të Koalicionit

Trupat drejtuese të Koalicionit janë:

- Kuvendi
- Këshilli koordinues
- Grupet koordinuese

### Neni 14.

#### Trupat profesionale-administrative të Koalicionit

Trupat profesionale-administrative të Koalicionit janë:

- Sekretariati/Sekretaria
- Komisioni Statutar

### Neni 15.

#### Vendimmarrja në Koalicionin.

(1) Trupat e Koalicionit plotfuqishëm vendosin me shumicën e votave të anëtarëve/reve prezentë të trupës në të cilën vendoset.

(2) Vendimi mbi: zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit koordinues, zgjedhjen e anëtarëve/reve në Komisionin Statutar, miratimin dhe ndryshim e Statutit, ankesat kundër vendimeve të Këshillit koordinues mbi përjashtimin e anëtarit/res nga Koalicionit dhe shuarja e Koalicionit merren me 2/3 e shumicës së votave të anëtarëve/reve prezentë në degët që marrin vendimin.

(3) Me përjashtim në raport me paragrafin (1) të këtij neni trupa e cila vendosë ka mundësi që me Rregullore të punës ose me vendim të veçantë të parashohë mundësinë e marrjes të vendimit të caktuar me 2/3 e shumicës së votave të anëtarëve/reve prezentë ose me konsensus të anëtarëve/reve.

(4) Nëse në të njëjtën lëndë për të cilën voton trupa ekzistojnë më shumë propozim vendime, konsiderohet i miratuar ai propozim vendimi i cili merr numrin më të madh të votave të anëtarëve/reve prezentë.

(5) Anëtarët/et e Kuvendit dhe Grupeve koordinuese ka të drejtën në numrin e votave si vijon:

- a) Organizatat anëtare të Koalicionit: dy vota
- b) Personat anëtarë/re të Koalicionit: një votë

**Neni 16.**  
**Votimi në Koalicion**

- (1) Anëtarët/et e Kuvendit dhe grupeve koordinuese mund të votojnë personalisht ose përmes të të autorizuarve.
- (2) Një person mund të disponoj më së shumti tri prokura për votim në mbledhjen e Kuvendit ose mbledhjen e grupit koordinues.
- (3) Votimi është publik, përveç nëse anëtarët/et e trupës e cila merr vendim nuk vendos që për propozim vendimin konkret ta marrin me votim të fshehtë.
- (4) Anëtarët/et e degës të Koalicionit mund të votojnë për ose kundër propozimit ose të abstenojnë nga votimi.

**Neni 17.**  
**Kuvendi**

- (1) Kuvendi është trupa më e lartë e Koalicionit i cili udhëheqë me punët e Koalicionit dhe nxjerr Statutin dhe aktet e përgjithshme të cilat i janë lënë në kompetencë me këtë Statut.
- (2) Kuvendin e përbëjnë të gjitha anëtarët dhe anëtarët e Koalicionit.
- (3) Kuvendi aktivitetet vetanake i kryen në mbledhjet në të cilat marrin pjesë anëtarët/et e Kuvendit.
- (4) Mbledhja e rregullt e Kuvendit mbahet njëherë në vit. Mbledhjen e rregullt e thërret Këshilli koordinues.
- (5) Kuvendi mund të mbaj edhe mbledhje të jashtëzakonshme. Mbledhjen e jashtëzakonshme e thërret Këshilli koordinues si dhe/ose 1/3 e anëtarëve/reve të Koalicionit.
- (6) Rendi i ditës, propozim vendimet dhe materialin për mbledhjen e Kuvendit e përgatit thirrësi i të njëjtës.
- (7) Thirrësi duhet të iu dërgojë ftesën të gjithë anëtarëve/reve që janë të evidentuar në Regjistrin e anëtarëve/reve për mbledhje të Kuvendit, propozimin e rendit të ditës dhe materialet tjera relevante me së largu deri 14 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
- (8) Të drejtën e votimit në mbledhjen e Kuvendit e gëzojnë të gjithë/a përfaqësuesit/set e organizatave anëtare të Koalicionit dhe personat anëtarë/re të cilët e kanë regjistruar pjesëmarrjen e tyre në mbledhjen e Kuvendit:
  - a) Në rastin e organizatave anëtare të Koalicionit: me regjistrim dhe me dorëzimin e shkresës mbi mandatin të plotësuar, të vërtetuar dhe në bazë të së cilës merret kartela votuese , dhe
  - b) Në rast kur personi i anëtarit/es së Koalicionit: me regjistrim, në bazën e të cilit marrin kartelën për votim.

**Neni 18.**  
**Regjistrimi i anëtarëve/reve të Kuvendit**

- (1)Regjistrimi i anëtarëve /reve të Kuvendit për të fituar të drejtën e votimit bëhet para fillimit të mbledhjes së Kuvendit.
- (2)Anëtarësimi në Koalicion vërtetohet me shikim në Regjistrin e anëtarëve/reve.

**Neni 19.**  
**Kryesia e punës**

- (1)Mbledhjen e Kuvendit e udhëheqë Kryesia e punës e cila zgjidhet në fillim të mbledhjes, dhe e cila udhëheqë mbledhjen në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit.
- (2)Deri në përzgjedhjen e kryesisë së punës mbledhjen e Kuvendit e kryesojnë dy përfaqësues/se të organizatave nismëtare të iniciativës.
- (3)Organizatave nismëtare të iniciativës janë *Fondi për të drejtën humanitare nga Beogradi dhe Documenta*- Qendra për ballafaqim me të kaluarën nga Zagrebi.
- (4)Kryesia e punës është e përbërë nga shtatë anëtarë/re përfaqësues/se të organizatave anëtare të Koalicionit nga shtetet e theksuara në nenin 5. paragrafi (1) të këtij Statuti.

**Neni 20.**  
**Kompetencat e Kuvendit**

Kuvendi është trup për vendimmarrje, i cili:

- Miraton Statutin dhe ndryshimet në Statut
- Nxjerrë Rregulloren e punës së Kuvendit (në vazhdim: Rregulloren e punës)
- Miraton programin strategjik të Kuvendit
- Zgjedh dhe shkarkon anëtarët/et e Këshillit koordinues
- Shqyrton dhe miraton raportet e punës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit të cilat i paraqet Këshilli koordinues
- Përfundimisht vendosë mbi vendimin e Këshillit koordinues për përjashtimin e anëtarit/es së Koalicionit
- Përfundimisht vendosë mbi vendimin e Këshillit koordinues për shuarjen e Koalicionit
- Vendosë për të gjitha çështjet tjera me interes për Koalicionin.
- Zgjedh dhe shkarkon anëtarët/et e Komisionit Statutar.

**Neni 21.**

Me Rregulloren e punës përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve/reve të Kuvendit si dhe rregullohet mënyra e thirrjes së Kuvendit, përcaktimit të rendit të ditës, udhëheqja dhe mbarëvajtja e



mbledhjes, mënyra e vendimmarrjes, mbajtjes së procesverbalit, zgjedhjes për organet e Koalicionit si dhe çështje tjera nga korniza e kompetencave të Kuvendit.

## **Neni 22. Këshilli koordinues**

(1) Këshilli koordinues është trupi udhëheqës i Koalicionit. Përbëhet nga 17 anëtarë/re të cilët i zgjedh Kuvendi.

(2) Për shkak të zbatimit të vendimeve të Këshillit koordinues në terren sigurohet përfaqësimi në mënyrën si vijon: Bosnja dhe Hercegovina (4), Mali i Zi (2), Kroacia(3), Kosova (3), Maqedonia (1), Sllovenia (1) dhe Serbia (3).

(3) Propozimin për zgjedhjen e anëtarit/es së Këshillit koordinues mund ta ushtroj çdo anëtar/e e Koalicionit.

(4) Sekretariati/Sekretaria të gjitha propozimet ia dërgon Këshillit koordinues i cili harton listën përfundimtare të kandidatëve dhe ia dërgon anëtarëve/reve të Kuvendit më së largu 7 ditë para fillimit të mbledhjes së Kuvendit.

(5) Këshilli koordinues takohet, së paku, njëherë në dy muaj.

(6) Në mbledhjet e Këshillit koordinues marrin pjesë anëtarët/et e Sekretariatit /Sekretarisë (koordinatori/ja rajonale për konsultime, përfaqësuesit/set e organizatave që ofrojnë mbështetjen administrative dhe teknike në organizimin e konsultimeve) dhe sipas nevojës edhe përfaqësuesit/set e organizatorit të konsultimeve dhe përfaqësuesit/set anëtare të Koalicionit, pa të drejt në vendimmarrje, mirëpo prezenca e tyre është e rëndësishme për shqyrtimin e çështjeve të parapara me rendin e ditës.

(7) Këshilli koordinues miraton Rregulloren e punës të Këshillit koordinues, e cila në detaje e rregullon punën e tij.

(8) Mandati i anëtarëve/reve të Këshillit koordinues është tri vjet.

(9) Anëtarësimi në Këshillin Koordinues automatikisht pushon me vendim personal, në rast vdekje të anëtarit/es, me ndërprerjen e anëtarësisë në Koalicionin dhe mosardhjen e paarsyeshme në mbledhjet e Këshillit koordinues pandërprerë dy herë radhazi.

(10) Këshilli koordinues mund të kooptoj anëtarin/ren e re me propozim të cilitdo anëtar/reje të Koalicionit, në vend të anëtarit/res të cilit/cilës i ndërpritet Anëtarësimi sipas shkaqeve të theksuara në paragrafin 9 të këtij neni. Vendimi për anëtarin/ren e re të Këshillit koordinues merret me konsensus. Kuvendi konfirmon (verifikon) vendimin në mbledhjen e parë të radhës. Nëse ma shumë se 5 anëtarë/re të zgjedhur nga ana e Kuvendit pushojnë të jenë anëtarë/re të Këshillit koordinues, ky trup ka për obligim që në afat prej 2 muajve të konvokojë (thërret) Kuvendin e jashtëzakonshëm.

### **Neni 23.**

#### **Kompetenca e Këshillit Koordinues**

Këshilli koordinues :

- Këshilli Koordinues është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Kuvendit dhe sjell vendimet nga fushëveprimi i tij ndërmjet dy seancave të Kuvendit
- Bazuar në programin strategjik apo dokumentit strategjik të Kuvendit përgatitë dhe realizon planin operativ të aktiviteteve të Koalicionit për KOMRA
- Jep miratimin organizatave dhe individëve për zbatimin e aktiviteteve individuale dhe projekteve në emër të Koalicionit
- Shqyrton raportet mbi realizimin e projektit dhe raportet financiare, që organizatat bartëse të projekteve iu paraqesin donatorëve
- Në çdo tremujor shqyrton dhe jep vlerësime mbi punën e Sekretariatit /Sekretarisë
- Propozon ndryshimet e Statutit
- Miraton Rregulloren e punës të Këshillit koordinues si dhe akte tjera të përgjithshme dhe të veçanta që ndërlidhen me punën e Koalicionit
- Formon dhe nxjerr vendim mbi ndërprerjen e punës së Sekretariatit/Sekretarisë
- Nxjerr vendim mbi përjashtimin e anëtarit/es nga Koalicioni
- Propozon Kuvendit vendimin mbi bashkëpunimin strategjik me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare, organizata dhe koalicione
- Përgatit dhe i paraqet Kuvendit raportin mbi punën
- Në përputhje me nevojat e Koalicionit mund të formojë edhe trupa tjera *ad hoc*
- Ushtron edhe aktivitete tjera të nevojshme për punën e Koalicionit.

### **Neni 24.**

#### **Grupet Koordinuese**

(1) Në disa prej shteteve të përmendura në nenin 5, sipas nevojës formohen grupe koordinuese të përbëra nga anëtarët/et e Koalicionit nga ato shtete.

(2) Ato i themelojnë anëtarët/ret e Koalicionit ose Këshilli koordinues me propozim të anëtarëve/reve të Koalicionit nga shtetet përkatëse.

(3) Grupet koordinuese miratojnë Rregulloren e punës të Grupeve koordinuese , të cilat në detaje e rregullojnë punën e tyre.

(4) Rregullorja e punës e Grupeve koordinuese duhet të jetë në përputhje me Statutin.

**Neni 25.**  
**Kompetencat e Grupeve koordinuese**

Grupet koordinuese:

- Zbatojnë vendimet e Këshillit koordinues lidhur me veprimet dhe qëllimet e Koalicionit në shtetin e caktuar dhe përgatisin propozim planin e aktiviteteve të Koalicionit në shtetin përkatës në përputhje me planin operativ të procesit konsultativ të cilin e nxjerrë Këshilli koordinues ;
- Aplikojnë planin operativ të procesit konsultativ;
- Pranojnë propozime dhe propozojnë anëtarët/et e Këshillit koordinues ;
- Përgatisin dhe i paraqesin Këshillit koordinues raportin e punës.
- Takohen njëherë në dy muaj në kornizat e konsultimeve lokale dhe nacionale dhe shqyrtojnë punën e koordinatorëve/reve nacional si dhe rrjedhat e procesit konsultativ në ndonjërin prej shteteve.

**Neni 26.**  
**Sekretariati/Sekretaria**

(1) Sekretariati është trupë mbështetës teknik, i cili është përgjegjës për punën e Këshillit koordinues. Përbëhet nga koordinatori/ja rajonale, koordinatorët/et nacionale (koordinatorët/et në vendet përkatëse) dhe përfaqësuesit/set e organizatave që ofrojnë mbështetjen teknike në organizimin e aktiviteteve të Koalicionit.

(2) Sekretariati/Sekretaria përcjellë punën e Këshillit koordinues dhe të grupeve koordinuese, përgatit konsultimet dhe forumet, si dhe ngjarje të tjera sipas udhëzimeve të Këshillit koordinues.

(3) Sekretariati/Sekretaria në çdonjërin prej shteteve vepron përmes koordinorit/es nacional (një ose më shumë), i cili/cila mund të jetë i/e punësuar në organizatën e cila ofron mbështetjen teknike në organizimin e konsultimeve dhe aktiviteteve tjera të Koalicionit.

**Neni 27.**  
**Zyrat**

(1) Zyrat/drejtoritë përcjellin punën e Këshillit koordinues, përgatisin konsultime dhe forume, si dhe ngjarje tjera në ende të caktuara sipas udhëzimeve të Këshillit koordinues.

(2) Punën e zyrave në vende të caktuara e organizon koordinatori/rja nacionale.

(3) Zyrat i themelon Këshillin koordinues.

**Neni 28.**  
**Komisioni Statutar**

(1) Komisioni statutar përcjellë respektimin e Statutit dhe përgjigjet në kundërshtimet që ndërliken me

shkeljet e Statutit, e që mund ta bëjë çdonjëri/njëra anëtarë/re e Koalicionit kundër çdonjërit/njëres anëtarë/re të Koalicionit.

(2)Komisioni statutar ka tre anëtarë/re nga fusha e shkencave juridike.

(3)Komisioni statutar është i obligueshëm që në afat prej 15 ditësh Këshillit koordinues të ia dërgojë propozim vendimet lidhur me kundërshtimet për shkelje të Statutit.

## **Financimi i aktiviteteve të Koalicionit**

### **Neni 29.**

#### **Dispozitat e përgjithshme mbi financimin e aktiviteteve të Koalicionit**

(1) Aktivitetet financohen:

- Nga fondet të cilat veprojnë në përputhje me ligjin
- Nga dhuratat
- Nga kontributet vullnetare të personave fizik dhe juridik
- Nga sponsorimet dhe donacionet
- Nga burime tjera në përputhje me ligjin.

(2) Raportet financiare janë të hapura për vrojtim të anëtarëve/reve të Koalicionit si dhe publikut të gjerë.

### **Neni 30.**

#### **Projektet e anëtarëve/reve të Koalicionit**

(1)Çdo anëtar/re e Koalicionit mund të parashtrij projekt propozim në Këshillin Koordinues, i cili e shqyrton dhe aprovon projekt propozimin.

(2)Bartësi i projektit është drejtpërdrejt përgjegjës për realizimin e aktiviteteve dhe shfrytëzimin e mjeteve.

(3)Bartësi i projektit është i obliguar që Këshillit koordinues ti parashtrij raportet financiare narrative mbi realizimin e projektit, të cilat ia paraqet donatorit.

4)Çdo shfrytëzim i paautorizuar i emrit KOMRA ose keqpërdorimi i mjeteve të përfituara për zbatimin e aktiviteteve bart me vete edhe përjashtimin e organizatës nga Koalicioni, si dhe bërjes publike të shkaqeve për përjashtim.

## **Dispozitat tjera**

### **Neni 31. Gjuha e Statutit**

Ky Statut është hartuar në gjuhën shqipe, boshnjake, malazezeve, kroate, hungareze, maqedone, rome, sllovene, serbe dhe turke, dhe që secila është version zyrtar dhe e barabartë me të tjerat.

### **Neni 32. Miratimi dhe ndryshimi i Statutit**

(1) Ndryshimet e Statutit mund të propozojnë :

- Këshilli koordinues
- Dhjetë organizata anëtare të Koalicionit
- Njëzet individ anëtarë/re të Koalicionit.

(2) Ndryshimet e Statutit hyjnë në fuqi menjëherë me miratim.

### **Neni 33. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të Statutit**

(1)Ky Statut hyn në fuqi menjëherë me miratimin në mbledhjen e Kuvendit në Sarajevë, me 26. qershor 2010.

(2) Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i nxjerrë në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur në Novi Sad, në muajin mars të vitit 2010.